



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **94**

Prishtinë, më 12.11.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Salih Morina dhe Boban Todorović.

Mungoi : Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 6.11.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin me Komplekset memoriale,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.11.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 6.11.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin me Komplekset memoriale

Kryetari i Komisionit Nait Hasani përshëndeti të pranishmit duke pyetur për mundësinë e përfundimit të këtij Projektligji sa më urgjent ngase edhe ashtu afati për shqyrtim është në përfundim e sipër (leximi parë është bërë më 13.9.2012). Shumica e anëtarëve të Komisionit u pajtuan se dispozitat e hartuara të Projektligjit duhet të përshtaten me dispozitat tani që sugjerohen për shkak se Agjencia sugjerohet të themelohet si organ që do të mbikëqyret nga Kuvendi i Kosovës.

Liburn Aliu ishte i mendimit se paraprakisht duhet të sqarohet çështja e shpalljes dhe menaxhimit, dmth ky Ligj vetëm do të menaxhoi komplekset apo edhe do ti shpallë. Ai shtoi se nismën për të shpallur një heroj apo një vlerë, bashkë me mendimin profesional duhet të jap institucioni kompetent (Akademia etj), ngase me siguri do të kemi keqpërdorime.

Afërdita Berisha ishte e mendimit se kjo pyetje rregullohet me Nenin 3 pika 6 ku potencohet edhe shpallja. **Salih Morina** konstatoi se Qeveria është ai organ që shpallë, dhe rikujtoi se Komisioni është dakorduar për një ekspert në këtë Projektligj, propozoi që të shtyhet për javën tjetër kjo çështje, dhe të vendos Komisioni me unanimitet. Gjithashtu tha se me këtë çështje duhet të njoftohet edhe Kryesia e Kuvendit. **Remzush Latifi** nga MMPH tha se është Ligji i veçantë që rregullon zonat e veçanta, mirëpo shumica e anëtarëve thanë se ajo nuk ka të bëjë me këtë çështje.

Komisioni në parim u pajtua si vijon :

Neni 1 – mund të mbetet ashtu si është.

Neni 2 – përkufizimet të ndryshohet konform sugjerimit për ndryshim.

Neni 3 – pika 9 të fshihet.

Neni 4 – paragrafi 2 të caktoi raportin të cilin duhet të hartoi Agjencia.

Neni 5 – Fjala “Mision” të zëvendësohet me “Synim” apo një tjetër që përshtatet më mirë.

Neni 6 – Kryeshefi propozon stemën apo kush ?

Neni 7 – të ceket Ligji në vend të “legjislacionin në fuqi”.

Neni 8 – kush i nxjerr aktet nënligjore.

Neni 9 – të fshihet pika 2.8.

Neni 11 – sikurse tek neni 8 (të shikohet si bëhet tek Agjencitë tjera).

Kryetari i Komisionit konstatoi se dilemat duhet të sqarohen deri në mbledhjen e radhës (shpallja e monumenteve nga kush bëhet, aktet nënligjore kush i nxjerr, zonat si shpallen etj) për çka do të angazhohet MMPH dhe stafi i Komisionit.

Liburn Aliu nuk kundërshtoi spastrimin e dilemave të parashtruara në këtë mbledhje.

4. Të ndryshme

Kryetari i Komisionit njoftoi për një ftesë nga Task Forca e Ministrisë së Integriteteve Evropiane rreth mbajtjes së një takimi në Durrës prej 15 deri 18 nëntor, duke hequr shpenzimet për Kryetarin e Komisionit, gjithashtu edhe për një pjestar të emërtuar nga stafi. Kryetari personalisht u deklarua se nuk mund të marr pjesë për shkak të obligimeve, ndërsa **Liburn Aliu** u deklarua se , poçes ka mundësi do të shkoi në këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12,40.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani